

A JENI DUKE PËRJETUAR NDONJË NGA SJELLJET E MËPOSHTME NGA DIKUSH NË JETEN TUAJ?

- ▶ Vazhdimisht kritikon pamjen tuaj, nënverson vendimet dhe mendimet e tua si dhe të fajson ty për gjithçka.
- ▶ Kërkon të dijë se ku jeni gjatë gjithë kohës duke ju shkruar vazhdimisht, telefonuar dhe gjurmuar lëvizjet e tua.
- ▶ Është xheloz, kontrollues dhe ju akuzon vazhdimisht për tradhti.
- ▶ Vazhdimisht do që ju të justifikoheni tek ai se ku i shpenzoni paratë dhe kërkon të marrë kontrollin e financave tua.
- ▶ Përpiqet që të ju izolojë nga miqtë, familjarët dhe kolegët dhe kërkon që ju të justifikoni çdo mungesë.
- ▶ Ju keqtrajton fizikisht në mënyra të ndryshme ose gjuan me sende drejt teje që të ju trembi ose të ju kërcënojë.
- ▶ Ju detyron të kryeni marrëdhënie seksuale, ju bën presion ose ju detyron të kryeni aktivitete seksuale të padëshiruara.

ZYRAT RAJONALE

- 1 Antrim, Ballymena, Carrickfergus, Larne & Newtownabbey Women's Aid
T: 028 2563 2136
- 2 Armagh Down Women's Aid
T: 028 3025 0765
- 3 Belfast & Lisburn Women's Aid
T: 028 9066 6049
- 4 Causeway & Mid Ulster Women's Aid
T: 0300 373 1055
- 5 Fermanagh Women's Aid
T: 028 6632 8898
- 6 Foyle Women's Aid
T: 028 7141 6800
- 7 North Down & Ards Women's Aid
T: 028 9127 3196
- 8 Omagh Women's Aid
T: 028 8224 1414
- 9 Women's Aid Federation
T: 028 9024 9041

**Nëse je në rrezik mos
hezito të kontaktosh
Policinë duke telefonuar
menjëhere në '999'.**

[womensaidni.org](https://www.womensaidni.org) 🔍



Women's Aid

Punojmë për ti dhënë
fund dhunes në familje



**NDIHMOJMË GRATE,
FËMIJET DHE TË RINJTË
TË PREKUR NGA
DHUNA NË FAMILJE**

ÇFARË ËSHTË DHUNA NË FAMILJE?

Women's Aid e përkufizon dhunen në familje si: dhunë fizike dhe emocionale e qëllimshme dhe e vazhdueshme ndaj një gruaje, ose ndaj një gruaje dhe fëmijëve të saj në një mënyrë që shkakton dhimbje, shqetësim ose lëndim.

Dhuna në familje përfshin abuzimin me fuqinë dhe kontrollin që një person ka mbi një tjetër, brenda marrëdhënieve intime ose familjes dhe zakonisht përshkallëzon në përsëritje dhe ashpërsi me kalimin e kohës. Dhuna në familje nuk është vetëm dhunë fizike por mund të marrë forma të ndryshme si fizike, verbale, psikologjike, ekonomike, seksuale dhe emocionale, të gjitha me synimin për të ju kontrolluar.

Sjellja shtërnguese dhe kontrolluese është dhunë dhe konsiderohet krim në Irlandën e Veriut. Ajo që është duke të ndodhur ty është e papranueshme dhe asnjëherë në rregull dhe për këtë arsye shërbimet mbështetëse janë këtu për të të ndihmuar.



SHËRBIMET PËRKTHYESE

Nëse ju keni nevojë të flisni me dikë në gjuhën tuaj të preferuar, Women's Aid mund të organizojë shërbime përkthimi sipas kërkesës tuaj.



**FIND YOUR LOCAL
WOMEN'S AID GROUP**

KUSH ËSHTË WOMEN'S AID?

Ne jemi organizata kryesore vullnetare në Irlandën e Veriut që trajtojmë dhunen në familje dhe ofrojmë shërbime të specializuara për gratë, fëmijët dhe të rinjtë.

Janë gjithsej 8 grupe lokale të Women's Aid në të gjithë Irlandën e Veriut, të cilët janë në gjëndje të flasin me ju në konfidencialitet të plotë për mbështetjen që mund të keni në dispozicion.

WOMEN'S AID IN NORTHERN IRELAND:

- Siguron strehim për gratë dhe fëmijët e tyre që vuajnë nga dhuna në familje.
- Siguron një sërë shërbimesh mbështetëse për gratë që janë duke përfunduar një marrëdhënie dhunuese.
- Ofron një sërë shërbimesh mbështetëse për fëmijët dhe të rinjtë që kanë përjetuar dhunë në familje.
- Punojmë në bashkëpunim me agjensitë përkatëse të bashkuar në përgjigje ndaj dhunës në familje.